number and their unique appearance somehow justify the attention paid to them, the historic socialist landscape in Albania comprises far more than bunkers; the ruins left by socialist economic policy, such as industrial complexes (e.g., *combines*), agricultural cooperatives, socialist urban design and its functional correlations and architecture, or propaganda elements like slogans on factory chimneys, walls, and mountains, are some of its most visible and significant elements. At least equally striking and omnipresent elements in those landscapes are the widely visible terraces and socialist monuments such as the lapidars. Whereas terraces were a typical *element of daily usage*, lapidars were intended as *static monuments*. Thus, lapidars were for socialist Albania also an instrument to define its territory and to border off its ideology from its neighbors. How far this went can be observed in the no-man's land between the Albanian–Greek border at Kakavijë [ALS–407] or the Albanian–Kosovar (former Yugoslavian) border at Qafë Prushë [ALS–549, ALS–550]. What all these elements share is their important role in generating the Albanian identity. For this reason, they were also reproduced in the *symbolic landscapes* of the Albanian propaganda, such as in the well-known painting “Kudo jemi në ballë” (“Everywhere we are on the forefront”) (fig. 1).

#### Dealing with lapidars and socialist monuments in Albania: The perception of different layers of history and their ambivalent handling

As elsewhere, Albania's urban and rural cultural landscapes are shaped by the influences of human interactions throughout time. Therefore, cultural landscapes can be considered as a “photographic plate,” registering human influences.<sup>20</sup> However, human development throughout history rarely follows a continuous, linear, and stable change, but is often stratified through abrupt shifting socio-economic and political settings (e.g., through wars, invasions, occupations, and revolutions). As described by Nitz, these “breaks” are mirrored in cultural landscapes.<sup>21</sup> For the territory of present-day Albania several cultural landscape layers and their breaking points may be identified (fig. 2).

In Albania the perception of those different layers of history is nowadays strongly influenced by the cultural and communicative memory of communism and

its post-socialist reactions. For this reason, the handling of the most recent elements of historic cultural landscapes is significantly different from the ones found in older layers, such as the Illyrian, Roman, and Ottoman periods, of which communicative memory has all but disappeared. Beginning with ancient history, all Illyrian structures in Albania's landscapes are not only highly accepted (even though resting on a scientifically unstable basis), but moreover serve as a main anchor point for the country's self-conception.<sup>22</sup> That the communist propaganda and historiography played an important role in creating a continuous line from Illyrians to communists in order to underpin their own claim to power, is nevertheless rarely reflected in the Albanian society.

Equally, Skënderbeg, the heroic fighter against the “Ottoman oppressors” is most important in this historiography and all physical leftovers from his works are precious to many Albanians. While the Ottomans are still often considered to be occupiers who caused a major setback in the development of the Albanian territory – a view that was also supported by communist historiography<sup>23</sup> –, the structures dating from the Ottoman period are strangely enough broadly accepted as an important part of the country's heritage. Parallel to these observations about the Ottoman period we should mention the ideological negligence of the Italian occupation but the acceptance of what they left as built heritage. For many, at this point the definition of what is “old” and “beautiful” and therefore worthy of protection, ends with this period of Albanian history. As a consequence Gazmend Bakiu's recent publication on “Old Tirana” finishes with evidence from 1940.<sup>24</sup> Here the factor *time* shows us how communicative history is consequently fading and with the taking over of the cultural memory the acceptance and neglect of historic cultural landscape elements is changing from an ideologically disclaimed to a more spatially accepted element.

Nearly 25 years after the end of the communist regime the handling of its built heritage seems much more complicated. Its grotesque spatial interventions still dominate the picture that most foreigners have of Albania. Although these cultural landscape-shaping elements are by many Albanians considered to be remind-

Jaap Scholten, *Concesco* (2012); Gylter Mydyti & Elian Stefa, *Concrete Mushrooms: Reusing Albania's 750.000 Abandoned Bunkers* (Barcelona: DPR-Barcelona, 2012).

20 Wolfgang Hartke, “Gedanken über die Bestimmung von Räumen gleichen sozialgeographischen Verhaltens,” *Erdkunde* 13.4 (1959).

21 Hans-Jürgen Nitz, “Brüche in der Kulturlandschaftsentwicklung,” in *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte – Geographie*, pp. 9–30.

22 See e.g. Oliver Jens Schmitt, *Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident* (Munich: Beck, 2012).

23 See e.g. Winfried Schenk, “Anmerkungen zum Verhältnis von Politik und Kulturlandschaftsentwicklung in Albanien,” in *Jüngere Fortschritte der regionalgeographischen Kenntnis über Albanien: Beiträge des Herbert-Louis-Gedächtnissymposiums*, ed. Hans Becker, Karsten Garleff, and Wilfried Krings (Bamberg: Fach Geographie an d. Univ., 1991), pp. 69–81, at pp. 78–9.

24 Gazmend Bakiu, *Tirana e vjetër: Një histori e ilustruar* (Tirana: MediaPrint, 2013).

ers of a repressive dictatorship, many of them also represent people's own contribution to shaping the country, spending countless hours doing the obligatory "voluntary work." For others, lapidars and socialist monuments are mere landmarks, used mainly as orientation points, sometimes even after their physical disappearance. For younger Albanians, raised after the end of communism, the historic socialist cultural landscapes are at most memorials that function as reminder of a recent, albeit not openly discussed history. If we observe the material collected during the Albanian Lapidar Survey, we can divide their current condition into four main categories:

- a. Destroyed, partially destroyed or vandalized;
- b. Ignored or (seemingly) neglected;
- c. Well-kept and conserved;
- d. Transformed or restored.

Although a clear categorization of each lapidar may not always be possible as there are hybrid forms, this rough categorization suggests different reasons for their varying conditions. A proper analysis of the communicative memory, that is, the range of the public's opinions about the perception of socialist cultural landscape elements remains essential to research on post-socialist cultural landscapes. Without such a proper qualitative study of this topic, we may not advance from the stage of hypotheses. Nevertheless, we may already propose a few conjectures based on the collected material and above categorization. The condition of a lapidar or socialist monument is – hypothetically – connected to (in weighted order):

1. Message;
2. Location;
3. Form (artistic appearance and size).

Ad 1. The message of a lapidar or socialist monument may be most crucial for its handling in a post-socialist society. Well-kept may be those that transmit a message that also in post-socialist Albania is considered important for the current understanding of history. Even though the partisans' fight against the fascist occupation is highly charged with communist propaganda, it remains for many Albanians an uncritically reflected historic fact and part of the national identity. For this reason, lapidars and socialist monuments that are directly commemorating partisans, and especially those ones, presenting important events, such as the monument of Drashovicë [ALS-438] or the names of single partisans, are usually well kept. Especially martyrs' cemeteries fall in this category, as state, society, or direct relatives of the partisans feel responsible for maintaining of their memory. Assmann concluded that via the preservation of its cultural memory, a

group stabilizes and transmits its identity.<sup>25</sup> Then reciprocally, the negligence and destruction of objectivized culture is an expression of a new and changed (counter-)identity. Therefore, more abstract lapidars, where no personal connection to a partisan can be made, or those ones commemorating the achievements of communism as an ideology itself, may instead more likely to be vandalized or partially or completely destroyed (e.g., the lapidar in Gorrë, ALS-324). These would processes akin to the *damnatio memoriae* that befell many busts and statues, directly commemorating communist leaders in other ex-socialist countries.

Ad 2. The location of a lapidar and socialist monument is crucial for its current condition in different ways; its distance from populated areas, whether it's blocking one of the many formal or informal construction works carried out during the transition period. On the one hand, the destruction of a lapidar may go hand in hand with the construction of a multi-story apartment complex, parking lot, street, etc. (e.g., ALS-162). On the other hand, we can observe many examples where construction works intentionally spared or at least relocated a lapidar rather than simply destroying it (e.g., ALS-200). Media attention was raised when the brother of Kruja's DP vice-mayor destroyed a lapidar "because it blocked his view."<sup>26</sup> This act may be connected to its spatial aspect. The hypothesis here is that in the still traditionally more DP-oriented north of Albania, especially during the early years of the transition, lapidars were more likely to be destroyed, their communist icons removed or vandalized with political statements than in the more SP-oriented south (e.g., the lapidars in Kalis, ALS-645 and Bajram Curri, ALS-540). Nevertheless, as the lapidars in the north are more often commemorating the fight against the Ottomans or "Serbian chauvinism" (e.g., the lapidar in Topojan, ALS-566), first hypothesis 1) should be considered as a reason why the overall level of destruction of lapidars might be equal in north and south.

Ad 3. Finally, not all lapidars and monuments can be removed, even if they are blocking an (often informal) construction, because of their sheer size. Similar to many bunkers, they might at most be integrated in constructions, such as walls or even

25 Assmann, "Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität," 15.

26 "I pengonte fushëpamjen, vëllai i kryetarit të Bashkisë shkël lapidarin, reagojnë veteranët," *NOA.al*: <http://www.noa.al/artikull/i-pengonte-fushëpamjen-vëllai-i-kryetarit-te-bashkise-shkul-lapidarin-reagojne-veteranet/406034.html> (Accessed July 21, 2014).

houses (ALS-563), or be transformed in order to create a new message. The lapidar along the road from Fushë-Krujë to Krujë (ALS-594) or the one close to Çauš (ALS-423) are best examples for the latter. Also it may happen that lapidars and socialist monuments are well-kept or at least not removed for their original artistic appearance. Especially the bigger monuments with a distinct and more complex appearance might more likely still exist.

### Different heritage values for strategy development

As mentioned above, the age factor significantly influences the handling of built structures. Alois Riegl, a pioneer in modern day heritage conservation, expressed this in his age value, which defines how a monument evokes feelings and remembrance because of its mere age. But, it must not be forgotten that there are several, equally set *heritage values*, defining the importance of a monument.<sup>27</sup> The values of inscribed and potential new heritages are idealistically consisting of esthetic, artistic, scientific, historic, and social aspects. A less broad, but in the scientific community more familiar, value is the *historic value*. According to this value, a heritage is seen as a historic document or testimony of the past that represents a closed period of human work.<sup>28</sup> Among many others, the *relative artistic value* must be mentioned here. This value admonishes to judge a monument not by personal means of esthetics, but by a “relative” or more objective opinion. When watching arts, architecture, and fashion through time, it becomes easily recognizable that they are subject to a constant change. Therefore, instead of based on contemporary standards of beauty a heritage should be valorized by the artistic skills that were necessary to create it.

The clear lines and abstract, sometimes seemingly cold or brutal, art and architecture of socialist realism stand in strong contrast with the forms of previous epochs. Yet the artistic skills that were needed to design a lapidar and socialist monument appear valuable upon reflection on the strict guidelines dictated by the communist regime. The high risk that comes with crossing those borders has been painfully observed by for example architect and artist Maks Velo or painter Edison Gjergo, who were both imprisoned for works that were deemed too modernist. Furthermore, if we take a look at the on the artistic and complex structures of the monuments at Mushqeta (ALS-304) or Pishkash (ALS-38), not only their *relative artistic value* can easily be recog-

nized. But even smaller structures, such as the lapidars of Frashër (ALS-243) or Pilur (ALS-430), bear with their unique simplicity a meaningful depth that may create their own kind of attractiveness for the eye of the beholder.

Without euphemizing a truly painful period in Albania’s past, the lapidars and socialist monuments captured in this publication manage to sensitize the reader to these values. But it does even more. By presenting the current condition of these potential heritages, the images manage to make us critically think about what will and should happen next. The often negligent attitude toward them sometimes inadvertently led to unique settings in the post-socialist environment. The martyrs’ cemetery of Sarandë (ALS-424), located between a hotel’s swimming pool, traditional Albanian houses, and new informal constructions, functions as a powerful visual example here.

From these different heritage values also different strategies for the handling of monuments emerge; the conservation of monuments from further degradation is the dictum of some conservationists that give special importance to the age value. Others proclaim that the restoration of monuments helps to preserve their potential for serving as a historic document, and for this reason they give highest importance to the historic value. In the praxis of heritage conservation these two different philosophies are continually in conflict. Even if there are global agreements, such as the so called “Venice Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites,”<sup>29</sup> there is as of yet no globally accepted guideline prescribing the handling of monuments by ascribing different levels of significance to heritage values. Whereas Georg Dehio, together with Riegl Europe’s second forefather of modern day’s heritage conservation, proclaimed “do *conserve*, not *restore*!” as his dictum,<sup>30</sup> e.g., in many Asian countries, the exact opposite is the case. Another, especially in recent years more observable praxis is taking restoration one step further: the reconstruction of formerly destroyed monuments. The Dresden Frauenkirche in Germany or the old town of the Polish capital Warsaw, both destroyed in WWII, are reconstructions, and both gave reason for heavy discussions among conservationists. Those seemingly problematic conflicting positions share but the potential for openly discussing the future handling of lapidars and socialist monuments as well as for developing sustainable

27 Alois Riegl, *Der moderne Denkmalkultus, sein Wesen und seine Entstehung* (Wien, Leipzig: W. Braumüller, 1903), p. 22.

28 Achim Hubel, *Denkmalpflege: Geschichte – Themen – Aufgaben. Eine Einführung* (Stuttgart: Reclam, 2006), pp. 78–81.

29 ICOMOS, International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites (The Venice Charter 1964): [http://www.icomos.org/charters/venice\\_e.pdf](http://www.icomos.org/charters/venice_e.pdf) (Accessed July 19, 2014).

30 See Georg Dehio and Alois Riegl, *Konservieren, Nicht restaurieren: Streitschriften zur Denkmalpflege um 1900* (Braunschweig, Wiesbaden: Friedr. Vieweg & Sohn, 1988).

policies for Albania's historic socialist landscape.

### Developing a cultural heritage policy for lapidars and socialist monuments

A basis for critical reflection on the socialist cultural landscape elements is a crucial factor for the still absent process of coming to terms with the socialist past.<sup>31</sup> Raising awareness about cultural landscapes in general and acknowledging their importance for education and generating identity as well as sensitizing the population about lapidars and socialist monuments as an element of the historic cultural landscapes would therefore contribute to the reflection on Albania's recent, inconvenient history. To do so institutional backing is crucial. Therefore the protection of lapidars and socialist monuments needs to be grounded on a legal basis. First and foremost the potential inscription of a monument should not be limited to a certain age. On first sight, a recent draft of amendments to the Law on Cultural Heritage (No. 9048), proposing to lower the minimum age for the inscription of heritage from 100 to 50 years, looks like a good start. Nevertheless, this would only encompass parts of the socialist period and arbitrarily cut through it. It would make much more sense to define a relative age for potential monuments. This could mean that for its inscription, a monument must be a testimony to a closed period of history, after which a distinct period of time must have passed, as a rule of thumb, the period of one generation or  $\pm 30$  years.<sup>32</sup> Furthermore, the Law on Cultural Heritage should include the possibilities to protect historic cultural landscapes. This would not just have binding character for landscape planning, but contribute to better protect the senses of identity and home in a rapidly changing environment.

Besides their legal protection the educational aspects of lapidars and socialist monuments as elements of historic cultural landscapes should be valorized. These can easily be prepared, e.g., for school and university curricula in the form of field trips or for public information in form of plates and plaques. This also includes making important sites, such as the martyrs' cemetery in Tirana,

openly accessible, actively promoting them as an accessible site. There are many examples from other parts of the world on how to sensibly deal and present "inconvenient" memorials. Besides widely known sites of fascist terror, like the "Documentation Centre Nazi Party Rally Grounds" in Nuremberg, memorial sites of the socialist past can be visited in some former socialist countries, such as Budapest's "Memento Park" or Sofia's "Museum of Socialist Art."

As basis for further steps in preservation and promotion, an inventory of the historic cultural landscapes and their elements would be needed. Again, there is plenty of experience in other countries. A modern inventory has the advantage that it may not just be only accessible in a single location, but that it can easily be designed as a globally accessible system. An example is the so called KuLaDig, a GIS (Geographic Information System) on the cultural landscapes of the German state of North Rhine–Westphalia. By publishing its documentation as open access data, the Albanian Lapidar Survey builds a great basis for further engagement in this field.

Besides the legal framework and technical assistance that would help preserving the historic socialist cultural landscapes of Albania, one must not forget that without the support of public opinion and the participation of society at large, the protection of those heritage sites and landscapes will not be sustainable. Especially in post-socialist Albania, with its long-lasting weakness of rule of law and instruments of planning, the direct impact of Albanian society on the appearance of the cultural landscapes, mainly due to the high rate of informal building activity, is much higher than in other countries. Therefore, not in the least an empiric study on the perception of lapidars and socialist monuments as elements of the historic cultural landscape, considering the different categories of destruction, negligence, maintenance, and transformation, is needed.

### Gains of an active protection of historic socialist landscapes

When historic cultural landscapes are protected, indicators for their preservation become necessary as their original function has ceased to exist. With the expression "'preserving' what became economically functionless, means in a capitalistic society 'subsidizing,'" Hauptmeyer articulated a major challenge for the preservation of historic cultural landscapes.<sup>33</sup> The educational aspect is what should make this challenge a surmountable one. To preserve historic socialist cultural landscapes, also

<sup>31</sup> Oliver J. Schmitt, "Die Herrschaft des Horrors: Albanien tut sich schwer mit der Bewältigung seiner Vergangenheit," *Neue Zürcher Zeitung*, July 23, 2012; Idriz Idrizi, "Zwischen politischer Instrumentalisierung und Verdrängung: Die Auseinandersetzung mit dem Kommunismus in Öffentlichkeit, Geschichtspublizistik und Historiografie im postkommunistischen Albanien," in *Jahrbuch für Historische Kommunismusforschung 2014*, ed. Ulrich Mählert et al. (Berlin: Metropol-Verlag, 2014), pp. 93–106, at pp. 105–6.

<sup>32</sup> Christoph Heuter, "Zu nahe dran? Bauten der 1960er Jahre als Herausforderung für die Denkmalpflege," in *denkmal!moderne: Architektur der 60er Jahre: Wiederentdeckung einer Epoche*, ed. Adrian v. Buttlar and Christoph Heuter, Jovis Diskurs (Berlin: Jovis, 2007), pp. 28–35, p. 28.

<sup>33</sup> Carl-Hans Hauptmeyer, "Kulturlandschaften aus regionalhistorischer Sicht," in *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte – Geographie*, pp. 301–13, at p. 309. My translation.



means to understand and acknowledge who has worked for them and that they may be an expression of poverty, suppression, or harm. If we do not valorize their educational aspect, cultural landscapes might just become a representative for mere beauty, rather than a place of remembrance.

Lapidars and socialist monuments are works of art, which especially in a rural environment are integrated in prominent settings or even explicitly form the crown of a landscape. Thus they become the rural equivalent to a *dominant urban structure* that essentially determines the total character of a landscape. If they were to be removed or neglected, feelings of loss and alienation will inevitably appear. Therefore, their preservation also implies supporting feelings of belonging and the Albanian identity. The importance of the protection of those feelings of belonging under the high dynamics of post-socialist development and the resulting rapid change of the cultural landscape is of special importance. New cultural landscapes are intentionally produced in order to generate new identity-building processes in post-socialist societies. The current “Disneyfication” of Skopje in the context of a massive project of a historicist reshaping of the inner city can be seen as a prominent example from neighboring Macedonia. Also Albania, in the framework of the 100th anniversary of national independence in 2012, witnessed the erection of numerous new monuments. At the same time, a massive, re-sanctification of space driven by external donors – i.e., the construction of hundreds of mosques and churches – is taking place. Due to their architectonic dominants (such as minarets and church towers), this process is highly influencing the current cultural landscapes. All this caused a rapid loss of what many define as home. That this is not merely a matter of the beauty of the landscape is shown by industrial heritage sites or the in the work of so-called “mall archeologists”: a group of people, which investigates deserted American shopping malls. From the emotional debate about the degradation of those former temples of consumerism, we can observe that it is the potential to remind us of our childhood that creates those feelings of homeliness.<sup>34</sup> This stands in no case in opposition to the inconvenient history those cultural landscape elements might represent. Examples from Germany show how the preservation of fascist heritage functions as “confirmative” heritage that contributes to a vital definition of a broad anti-fascist (national) identity. Being such an important visible element of Albania’s landscape lapidars and socialist monuments must be seen as both, as an important identity-generating structure for Albanians,

as well as an image-generating factor for visitors to the country.

The latter is what gives historic socialist cultural landscapes a high economic potential. The majority of foreign visitors come to Albania in part because (and not in spite of) its recent history. Curiosity for a political system about which only little information existed is part of the great attraction of today’s Albania. Besides a rich, ancient history and an impressive, yet highly threatened coastline, many tourists want to see and learn about the recent socialist past of the country. The historic socialist landscapes have an important part in transmitting this knowledge. Besides losing a chance to come in terms with history, neglecting them thus implies ignoring this economic potential. This does not mean that each bunker, all terraces, and every single lapidar must be preserved and restored against high costs for society. But many appropriate places exist that could be inscribed and actively protected as heritage sites, especially those that have a significant and high density of historic cultural landscape elements. Keeping in mind that ICOMOS has founded a task group for the inscription of testimonies of the former socialist system on the UNESCO’s list of World Heritage Sites, Albania has all opportunities to become a global trailblazer here.

### Conclusion

Although built during communism and representing socialist historiography, lapidars are not solely perceived as representing communism. Therefore, there is also no broad consensus that lapidars or socialist monuments should be neglected or removed in general. Lapidars and socialist monuments that thematize single elements or the entire lines of communist historiography, from the Illyrians via Skënderbeg to the partisans, continue to express “this is still us.” The more abstract commemorative expression of socialist ideals instead would express “this is not us anymore” and are therefore more likely to be neglected or destroyed. Not least, the well-kept and sometimes even restored lapidars against “Ottoman suppression” or “Serbian chauvinism” express “this will always have been them” or “this is still them,” which especially in the latter case and after the Kosovo war gained a strong momentum. This ultimately shows that the communist historiography is not just still present in post-socialist Albania, but is also generally accepted without much public critical reflection

Because of this, the handling of the built heritage from the communist period is currently a highly neglected topic in Albania. Hence the mere existence of this publication and its associated digital information system highly enriches the cultural memory about lapidars

34 Dix, “Grundsätze zur Definition und Bewertung historischer Kulturlandschaften,” p. 24.

and socialist monuments. At the same time, it creates a basis for reviving the communicative memory from its current oblivion. Even if communicative memory is limited in its endurance (3–4 generations, see above), every critically reflected discussion on this topic is an important element for the upkeep of Albania's oral history.

As the recent intensification in international research and public discussion on cultural landscapes and socialist monumentalism shows, it is not too late for Albania to engage in this field. It may even be concluded that now actually is the best time to start working on it. This means gathering empiric data and knowledge, creating a broad scientific, political, and public discussion, creating the right institutional framework and start protecting and promoting the touristic potential of lapidars and socialist monuments as part of Albania's historic cultural landscapes. And as the loss of valuable witnesses of the recent past is an ongoing process, the necessity to do so is strong and urgent.

# Lapidarët dhe monumentet socialiste si elemente të peizazheve kulturore historike të Shqipërisë

Matthias Bickert

“Me kalimin e viteve, për shkak të korrozionit dhe të patinaturave të kohëve, jashtë dhe brenda trurit tonë, e shkuara na shfaqet në kujtesë gjithnjë e më e sfumuar e më e copëzuar.”

Fatos Lubonja, “Ironia e tranzicionit”<sup>1</sup>

## Hyrje: Kujtesa kolektive e peizazheve kulturore

Një ditë, teksa blija ullinj tek Pazari i Ri, më kapën sytë një formë abstrakte pas tezgave (ALS-2). “Çfarë është?”, më pyeti një mik që kishte ardhur nga Gjermania. Pasi u përpoqa t’i shpjegoj se çfarë është një lapidar, ai donte t’i bënte një fotografi. Habia e shitësve, që nuk arrinin ta kuptonin se pse një të huaji mund t’i interesonte një strukturë betoni ku ata mbështesnin tezgat e frutave dhe kutitë e kartonit, ishte mjaft e lexueshme. Më vonë, gjatë rrugës për në Krujë, u ndeshëm me prototipe të tjera të këtyre skulpturave të çuditshme dhe obeliskëve të përmasave, formave dhe ngjyrave të ndryshme, që dominonin peizazhin shqiptar që na kalonte para syve nga dritarja e autobusit. Disa prej tyre ishin në gjendje të mjerueshme (p.sh. ALS-596), një tjetër e kishin transformuar në një stelë të mbuluar me fytyra që buzëqeshnin si fantazma. “Pse janë në gjendje kaq të ndryshme nga njëri tjetri nëse të gjithë i përkasin periudhës komuniste?” qe pyetja legjitime e mikut tim.

Në përpjekje për t’i dhënë një përgjigje kësaj pyetjeje, në këtë artikull do t’i trajtoj lapidarët dhe monumentet socialiste si elemente të peizazheve kulturore të Shqipërisë, duke theksuar rolin e tyre në perceptimin e peizazheve kulturore historike në Shqipërinë bashkëkohore, domosdoshmërinë për të nisur një debat mbi trashëgiminë materiale socialiste të vendit, dhe rëndësinë e një debati të tillë për konservimin dhe vlerësimin e lapidarëve dhe monumenteve socialiste si elemente të peizazheve kulturore historike.

Shumica e lapidarëve dhe monumenteve të ndërtuara gjatë periudhës komuniste ekzistojnë edhe sot e kësaj dite. Ato janë shumë më tepër se sa thjesht ndërtime guri, betoni dhe metal. Në vazhden e ideve të Maurice Halbwach-it mbi atë që ai e quajti *kujtesa e përbashkët*,

mund të themi se lapidarët janë një element i dijes së përbashkët, kujtesës së përbashkët, dhe mbi të gjitha i një identiteti shqiptar të përbashkët.<sup>2</sup> Jan Assmann e ndan kujtesën e përbashkët në kujtesë *komunikuese* dhe kujtesë *kulturore*. Termi “kujtesë komunikuese” i referohet kujtesës individuale që përcillet gojariht.<sup>3</sup> Për rrjedhojë, ajo zgjat jo më tepër se 3–4 breza ose, e thënë ndryshe, 80–100 vjet.<sup>4</sup> Termi “kujtesë kulturore” i referohet një kulture që është e prekshme dhe që ofron njohuri mbi të kalurën dhe të tashmen e një shoqërie. Mund të përfshijmë këtu objekte si për shembull pulla poste, afishe, fotografi, kostume, monumente, ndërtesa, madje edhe qytete, si dhe peizazhe. Kështu pra, lapidarët dhe monumentet e tjera socialiste, së bashku me peizazhet kulturore që formësojnë, janë pjesë e kujtesës kulturore të Shqipërisë. Ndonëse kujtesa kulturore bazohet në objekte konkrete, kjo nuk do të thotë se ato perceptohen në një mënyrë po aq objektive. Ashtu si kujtesa komunikuese, kujtesa kulturore ka një dimension subjektiv pasi ajo shpreh identitetin e një grupi të caktuar, duke përcjellë mesazhin “këta jemi ne” dhe anasjelltas (“ata janë të tjerët”).<sup>5</sup> Kjo nënkupton se një vendas e sheh të njëjtin peizazh kulturor ndryshe nga një i huaj, një individ nga zonat urbane ndryshe nga një individ nga zonat rurale, një socialist ndryshe nga një demokrat, e kështu me rradhë. Nga ana tjetër ama, prodhimi i një kulture të bazuar në objekte shfrytëzohet në mënyrë selektive për të (ri)prodhuar identitete: ngjarje dhe personazhe të caktuara në historinë e një vendi shndërrohen në pika “fikse” referimi që ngjajnë me ishuj kohorë, të cilët inkurajojnë reflektime të ndryshme re-

1 Fatos Lubonja, “Ironia e tranzicionit,” hyrje për C. Kleineidam & H.P. Jost, *Shqipëria në tranzicion 1991–* (Cyrih: Benteli, 2011), f. 12.

2 Maurice Halbwachs, *La mémoire collective* (Paris: Presses Universitaires de France, 1950): [http://www.psychanalyse.com/pdf/memoire\\_collective.pdf](http://www.psychanalyse.com/pdf/memoire_collective.pdf) (Hyrë 21 korrik 2014).

3 Jan Assmann, “Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität,” në *Kultur und Gedächtnis*, red. Jan Assmann (Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1988), f. 9–19; Jan Assmann, “Communicative and Cultural Memory,” në *Cultural Memory Studies: An International and Interdisciplinary handbook*, red. Astrid Erll dhe Ansgar Nünning (Berlin & Nju-Jork: De Gruyter, 2008), f. 109–18.

4 Jan Assmann, “Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität,” f. 11.

5 Po aty, f. 13.

trospetive.<sup>6</sup> Një tjetër atribut i kujtesës kulturore është riprodhimi i vetë kujtesës. Pra perceptimi i kujtesës kulturore evoluon në kohë.<sup>7</sup> Për rrjedhojë, as perceptimi i trashëgimive objektive të së kaluarës, dhe as diskutimet rreth tyre nuk garantojnë të “vërtetën” absolute.

### Rreth peizazheve kulturore

Për të kuptuar lapidarët dhe rolin e tyre në peizazhin kulturor post-socialist shqiptar është e domosdoshme të kuptojmë se në çfarë konsiston një peizazh kulturor. Në fakt, termi *peizazh kulturor* është mjaft amorf për shkak të mospajtit të përdorimeve shkecore dhe atyre të përditshme të termave “kulturë” dhe “peizazh”. Në këtë artikull, me fjalën “kulturë” do të kuptojmë çdo krijim të njerëzimit, pavarësisht veçorive të krijuesit. Sa i përket termit “peizazh”, ndonëse ekzistojnë shumë përkufizime shkecore, që zakonisht e përshkruajnë një peizazh si një copë të sipërfaqes së tokës që ka një “karakter tërësor” të posaçëm, duhet theksuar se këto përkufizime nuk e shohin asnjëherë peizazhin si diçka që është e paracaktuar dhe rrethuar nga natyra, por gjithmonë si manifestimi i një vlerësimi njerëzor.<sup>8</sup> Pra, mund të themi se peizazhet kulturore janë copëza të sipërfaqes së tokës që përbëjnë burime por edhe prova të prodhimit kulturor në të kalurën dhe në të tashmen. Kjo nënkupton që inventarizimi i tyre, sipas lidhjeve funksionale mes elementeve të ndryshme, shtresëzimeve historike, dhe rrezikshmërisë, është një ndër aspektet më të rëndësishme të njohjes së peizazheve kulturore. Këto tipare mund të vrojtohen vetëm pjesërisht nëpërmjet ekzaminimeve fizionomike, pasi shpeshherë elementet më të reja dhe ato më të vjetra shtresëzohen si një palimpsest. Vetëm nëpërmjet konsultimit të hartave, shkrimeve dhe statistikave mund të arrijmë të dallojmë elementet e ndryshme, siç është proceduar në rastin e Hulumtimit mbi Lapidarët e Shqipërisë.<sup>9</sup>

Në parim, peizazhet kulturore dallojnë nga peizazhet natyrore, që nuk janë pre e ndikimeve kulturore. Megjithatë, tashmë e gjithë hapësira e rruzullit tokësor është prekur apo po preket nga ndikimi njerëzor, kështu që edhe peizazhet natyrore mund të konsiderohen pei-

zazhe kulturore,<sup>10</sup> përfshirë këtu edhe peizazhet post-socialiste që kanë elemente të përmirësuar, taracat, apo ndikime të tjera të përpunimit të tokës.

Koncepti i peizazhit kulturor po zhvillohet e shtjellohet gjithnjë e më tepër. Sa i përket këtij artikulli, mund të përmendim botimet e ndryshme që kanë dalë mbi trashëgiminë arkitektonike socialiste. *Cultural Landscapes of Post-Socialist Cities (Peizazhet kulturore të qyteteve post-socialiste)* e Czepczyński-t (2008) ofron një diskutim shkencor të kësaj teme, ndërsa *Modernism In-Between (Modernizmi në kapërcyell)* nga Kulic et al. (2012) është një shembull i librave të shumtë të ilustruar të kohëve të fundit kushtuar trashëgimisë kulturore socialiste.<sup>11</sup> Fakti se më në fund ka ardhur koha për një diskutim të thellë të rolit që lapidarët dhe monumentet socialiste të Shqipërisë do të kenë mbi peizazhet kulturore të vendit në të ardhmen dëshmohet edhe nga nisma e UNESCO-s, “International Scientific Committee on Twentieth Century Heritage” (“Komiteti Shkencor Ndërkombëtar mbi Trashëgiminë e Shekullit XX”), ku ICOMOS (organi këshillimor më i rëndësishëm i UNESCO-s sa i përket trashëgimisë kulturore) debaton mundësinë për të shpallur disa përfaqësues të “trashëgimisë socialiste” si *World Heritage Sites (Vende të Trashëgimisë Botërore)*.<sup>12</sup>

Sipas teorisë së kujtesës së përbashkët, peizazhet kulturore janë produkte të ligjëratave të aktorëve të ndryshëm, që presupozon krijimin e politikave qeverisëse të posaçme.<sup>13</sup> Kjo perspektivë konstruktiviste mbështetet edhe nga e ashtuquajtura “European Landscape Convention” (“Konventa Evro-

<sup>10</sup> Po aty, f. 11.

<sup>11</sup> Roman Bezjak, *Socialist Modernism* (Ostfildern: Hatje Cantz, 2011); Frédéric Chaubin, *CCCP: Cosmic Communist Constructions Photographed* (Köln: Taschen, 2011); Mariusz Czepczyński, *Cultural Landscapes of Post-Socialist Cities: Representation of Powers and Needs, Re-materialising Cultural Geography* (Aldershot, England & Burlington, VT: Ashgate, 2008); Jan Kempnaers dhe Willem Jan Neutelings, *Spomenik* (Amsterdam: Roma Publications, 2010); Vladimir Kulić, Maroje Mrduljaš dhe Wolfgang Thaler, *Modernism In-Between: The Mediatory Architectures of Socialist Yugoslavia* (Berlin: Jovis, 2010); Katharina Ritter, *Soviet Modernism 1955–1991: An Unknown History* (Cyrih: Park Books, 2012).

<sup>12</sup> ICOMOS, “Invitation to Participate in ISC20C Project for Conserving Socialist Heritage” (International Council on Monuments and Sites, 2013: [http://www.docomomo.de/attachments/387\\_B\\_ICOMOS\\_20C\\_LETTER%20Project%20for%20Conserving%20the%20Socialist%20Heritage%20of%20the%20Post-War%20World.pdf](http://www.docomomo.de/attachments/387_B_ICOMOS_20C_LETTER%20Project%20for%20Conserving%20the%20Socialist%20Heritage%20of%20the%20Post-War%20World.pdf)).

<sup>13</sup> Gailing & Röhring and Fürst et al. u citua nga Winfried Schenk, “Merkmale urbaner Kulturlandschaft im Kontext aktueller Planungsdiskurse um ‘Kulturlandschaft,’” në *Stadt – Kultur – Landschaft*, red. Deutsche Bundesstiftung Umwelt (DBU) dhe Deutsche Gesellschaft für Gartenkunst und Landschaftskultur (DGGL) (Berlin: Deutsche Gesellschaft für Gartenkunst und Landschaftskultur [DGGL], 2009), f. 11–4, në f. 12.

<sup>6</sup> Po aty, f. 12.

<sup>7</sup> Po aty, f. 13–4.

<sup>8</sup> Uta Steinhardt, Heiner Barsch dhe Oswald Blumenstein, “Landschaft als Gegenstand wissenschaftlicher Erkenntnis,” në *Lehrbuch der Landschaftsökologie*, red. Uta Steinhardt, Heiner Barsch and Oswald Blumenstein (Heidelberg: Spektrum Akademischer Verlag, 2012), f. 23–69, at f. 32.

<sup>9</sup> Andreas Dix, “Vorindustrielle Kulturlandschaften. Leitlinien ihrer historischen Entwicklung,” në *Die Veränderung der Kulturlandschaft: Nutzungen, Sichtweisen, Planungen*, red. Günter Bayerl and Torsten Meyer (Mynster, Nju-Jork, Mynih, Berlin: Waxmann, 2003), f. 11–31, at f. 13.



Fig. 1 Peizazh socialist shqiptar stereotipik: Vilson Halimi, "Kudo jemi ne ballë," 1976, vaj në pëlhurë, 145 × 200 cm. Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë. Në skajin e djathtë dallohet një lapidar.

piane e Peizazhit"),<sup>14</sup> një traktat ndërkombëtar që synon mbrojtjen, planifikimin dhe menaxhimin e problematikave specifike të peizazhit evropian. Në këtë traktat, peizazhi përkufizohet si një "zonë që perceptohet si e tillë nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimeve dhe ndërveprimeve mes faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë."<sup>15</sup> Rrjedhimisht, peizazhet duhen perceptuar si djepi i identitetit kulturor, trashëgimisë së përbashkët, dhe larmisë evropiane.<sup>16</sup>

Në vijim të sugjerimit të Freytag-ut se "historia objektivizohet në peizazhet ku u shpalos, dhe tashmë është qartësisht *in-situ*, njëmijë-vjeçarja aty ku ndodhen e djeshmja dhe e tashmja",<sup>17</sup> mund t'i kthehemi *peizazheve kulturore historike*. Peizazhi kulturor historik është një

pjesëz e një peizazhi kulturor ekzistues që dominohet nga elemente historike. Këto elemente cilësohen si dëshmitarët e veprave të brezave të mëparshëm, vepra që përndryshe nuk do të shfaqeshin ashtu si në rrethana të mëhershme socio-ekonomike, ose thjesht nuk do të shfaqeshin.<sup>18</sup> Për pasojë, në një botë post-socialiste të gjitha elementet që formësuan peizazhin kulturor të periudhës socialiste janë automatikisht elemente të peizazheve kulturore historike. Për më tepër, një peizazh kulturor historik që dominohet nga një densitet i lartë elementesh të peizazhit kulturor socialist mund të quhet një *peizazh socialist (kulturor) historik*.

Vitet e fundit, bunkerët janë shndërruar në një element stereotipik të peizazhit socialist historik të

14 Po aty.

15 "European Landscape Convention: ETS No. 176," Council of Europe: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/176.htm> (Hyrë 19 korrik 2014). Theksimi im.

16 Schenk, "Merkmale urbaner Kulturlandschaft," f. 12.

17 Carl-Hans Hauptmeyer, "Kulturlandschaften aus regionalhistorischer Sicht," në *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte –*

*Geographie*, red. Klaus Fehn (Bonn: Siedlungsforschung, 1996), f. 301–13, në f. 310.

18 Andreas Dix, "Grundsätze zur Definition und Bewertung historischer Kulturlandschaften," në *Historische Kulturlandschaft und Denkmalpflege: Definition, Abgrenzung, Bewertung, Elemente, Umgang*, red. Birgit Franz dhe Achim Hubel (Holzminden: Mitzkat, 2010), f. 22–9, në f. 25.




Fig. 2 Shtresat e peizazheve kulturore të Shqipërisë (të modifikuara dhe të përkthyer sipas Schenk, "Anmerkungen zum Verhältnis von Politik und Kulturlandschaftsentwicklung in Albanien," f. 71)

Shqipërisë, siç evidentohet edhe nga numri i konsiderueshëm i botimeve të cilësive të ndryshme mbi këto “kërpudha prej betoni”.<sup>19</sup> Ndonëse numri i tyre i konsiderueshëm dhe pamja e tyre unike e justifikojnë deri diku interesin që kanë ngjallur, peizazhi socialist historik në Shqipëri është mjaft i pasur dhe përfshin edhe rrënojat e politikave ekonomike socialiste, si për shembull komplekset industriale (kombinatet), kooperativat bujqësore, planifikimin urbanistik socialist dhe arkitekturën socialiste, si dhe elemente propagandistike si slogonet nëpër oxhaqet e fabrikave, mure dhe faqe malesh. Po aq të spikatura dhe të kudondodhura janë taracat dhe monumentet socialiste, si për shembull lapidarët. Ndërsa taracat janë shembulli tipik i një *elementi të përdorimit të përditshëm*, lapidarët u konceptuan si *monumente statike*. Kështu pra, për Shqipërinë socialiste lapidarët luanin rolin e një instrumenti që përcaktonte territorin e saj dhe që dallonte ideologjinë e saj nga ajo e vendeve fqinje. Shtrirjen e këtij fenomeni e shohim në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë në Kakavijë [ALS-407], dhe atë midis Shqipërisë dhe Kosovës (ish-Jugosllavisë) në Qafë Prushë [ALS-549, 550]. Megjithatë, të dyja këto elemente luajtën një rol të rëndësishëm në krijimin e identitetit shqiptar. Pikërisht për këtë arsye këto elemente u ripridhuan edhe në *peizazhet simbolike* të propagandës shqiptare, si për shembull në pikturën e mirënjohur “Kudo jemi në ballë” (fig. 1).

### Si t’i trajtojmë lapidarët dhe monumentet socialiste në Shqipëri: Perceptimi i shtresave të ndryshme të historisë dhe ambivalenca ndaj tyre

Si kudo tjetër, peizazhet kulturore e rurale të Shqipërisë janë formuar nga ndikimi i ndërveprimeve njerëzore gjatë kohës. Kështu, peizazhet kulturore mund të konsiderohen si një “lastër fotografike” që regjistron ndikimin njerëzor.<sup>20</sup> Megjithatë, në historinë e njerëzimit zhvillimi rrallëherë merr formën e një ndryshimi të vazhdueshëm, të qëndrueshëm e linear. Përkundrazi, ai shpesh shtresëzohet falë ndryshimeve të papritura të kushteve socio-ekonomike e politike (si p.sh. luftërave, pushtimeve dhe revolucioneve). Siç shkruan Nitz, këto “çarje” reflektohen në peizazhet kulturore.<sup>21</sup> Në territorin e sotëm të Shqipërisë mund të identifikojmë disa

shtresa të peizazhit të saj kulturor dhe çarjet mes tyre (fig. 2).

Sot në Shqipëri perceptimi i këtyre shtresave të ndryshme të historisë ndikohet fuqishëm nga kujtesa kulturore dhe komunikuese e komunizmit dhe reagentet post-socialiste. Për këtë arsye, trajtimi i elementeve më të reja të peizazheve kulturore historike ndryshon shumë nga trajtimi i elementeve të shtresave më të vjetra, si ato të periudhave ilire, romake e otomane, kujtesa komunikuese e të cilave është zhdukur. Duke filluar me historinë antike, të gjitha strukturat ilire në peizazhet e Shqipërisë jo vetëm që pranohen (ndonëse bazohen në themele shkencore të paqëndrueshme), por shërbejnë edhe si një tjetër pikë referimi për vetë-konceptimin e vendit.<sup>22</sup> Fakti që propaganda dhe historiografia komuniste luajtën një rol të rëndësishëm në krijimin e një vije të drejtë e të pandërprerë nga ilirët deri tek komunistët për të legjitimuar pushtetin e tyre, rrallëherë merret në konsideratë në shoqërinë shqiptare.

E njëjta gjë ndodh edhe me Skënderbeun, luftëtarin heroik kundër “pushtuesit otoman” që luan një rol po aq të rëndësishëm në këtë historiografi – ajo çfarë ka mbetur nga vepra e tij është e shtrenjtë për shumë shqiptarë. Ndonëse otomanët ende konsiderohen si pushtues që frenuan e penguan zhvillimin e trojeve shqiptare – edhe ky një qëndrim i mbështetur nga historiografia komuniste<sup>23</sup> – strukturat e kësaj periudhe çuditërisht pranohen gjerësisht si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së vendit. Në parantezë, ia vlen të përmendim këtu edhe neglizhimin ideologjik të pushtimit Italian, por pranimin e asaj që ata lanë pas si trashëgimi e ndërtuar. Për shumë shqiptarë, në këtë moment të historisë së Shqipërisë përfundon edhe ajo që mund të cilësohet si e “vjetër” dhe e “bukur” e që ia vlen të mbrohet. Për pasojë, një botim i kohëve të fundit i Gazmend Bakiut mbi “Tiranën e Vjetër” përfundon në vitin 1940.<sup>24</sup> Këtu faktori *kohë* tregon se si kujtesa komunikuese sa vjen e venitet, ndërkohë që kujtesa kulturore vjen në plan të parë. Për pasojë, pranimi apo shpërfillja e elementeve të peizazhit kulturor, nuk ka të bëjë edhe aq me një ideologji të refuzuar se sa me një dimension hapësinor të pranueshëm.

Njëzet e pesë vjet pas përfundimit të regjimit ko-

19 P.sh. Alicja Dobrucka, “Mapping Bunkers”: <http://www.domusweb.it/en/photo-essays/2012/04/03/mapping-bunkers.html> (Hyrtë 19 korrik 2014); David Galjaard, Slavenka Drakulić dhe Jaap Scholten, *Concesco* (2012); Gylter Mydyti & Elian Stefa, *Concrete Mushrooms: Reusing Albania's 750.000 Abandoned Bunkers* (Barcelonë: DPR-Barcelona, 2012).

20 Wolfgang Hartke, “Gedanken über die Bestimmung von Räumen gleichen sozialgeographischen Verhaltens,” *Erdkunde* 13.4 (1959).

21 Hans-Jürgen Nitz, “Brüche in der Kulturlandschaftsentwicklung,” in *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte – Geographie*, f. 9–30.

22 Shih p.sh. Oliver Jens Schmitt, *Die Albanen: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident* (Mynih: Beck, 2012).

